



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT PER 8-MUJORIN 2018

Te nderuar keshilltare!

Në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Per financat e vetëqeverisjes vendore”, Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”, nenit 65 të ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, nenit 9 pika 1.3 germa Ç, neni 34 pika 6, të ligjit 139/215 “ Per veteqeverisjen vendore” , po ju paraqesim raportin e monitorimit të zbatimit të treguesve të buxhetit për 8- mujorin Janar-gusht 2018.

Bashkia Berat miratoi buxhetin e vitit 2018 me VKB nr.98 date 15.12.2017 dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr. 2052/1 date 22.12.2017, i cili me pas u dergua për celje prane deges se thesarit brenda afatit ligjor .

Me VKB nr. 16 date 16.02.2018 konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr 468/1 date 20.02.2018, u miratua shtesa e buxhetit të bashkise për të ardhurat e trasheguara nga viti 2017 në vitin 2018, buxhet i cili u bë efektiv prane deges se thesarit Berat.

Ndryshimet e buxhetit gjatë 4- mujorit të dytë (maj-gusht 2018), u vendimuar në Keshillin Bashkiak me VKB nr.87 date 26. 07.2018 , konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr 2121/1 date 30.07.2018. Mbi bazën e këtij Vendimi plani i të ardhurave të bashkise u rrit me 22 346 000 leke (të ardhura nga qerata e banesave sociale si dhe të ardhura nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi).

- Total plani i të ardhura shkon në 505 071 000 leke,
- Plani i të ardhurave si 8- mujor 321 817 000 leke
- **Fakti 8- mujor 231995 000 leke, ose është realizua 72% e planit.**
- mos realizimi në vlerë 89 822 000 leke ose 28% e planit pa realizuar

U planifikuan në total shpenzime në 8- mujori janar-gusht 2018 në shumën 860 568 000 leke, dhe u shpenzuan në fakt në shumën 616 950 000 leke ose 72% e planit.

Realizimi i shpenzimeve në total për Bashkinë Berat sipas njësive shpenzuese paraqitet si më poshtë:

Njesia Shpenzuese	Buxheti Vjetor 2018	Plan 8-Mujor	Fakt 8-Mujor	%
Bashkia	605,372	441,963	283,332	64
MZSH, Menaxh. bashkia	37,954	27,811	19,994	72
Ndermarrja e Gjelberimit	41,236	29,660	26,989	91
Nd.e Shërbimeve Publike	86,120	60,710	53,142	88
Drejtoria Arsimore	283,379	215,747	162,983	76

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Drejtoria e Bujqesise	48,600	38,117	29,752	78
Qendra Kulturore	35,718	26,920	25,886	96
Qendra Lira	26,611	19,640	14,872	76
Total Bashkia	1,164,990	860,568	616,950	72

A. NJESIA SHPENZUESE: BASHKIA BERAT,

Menaxhon 54.5% te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

- ❖ Planifikim menaxhim administrim, perfshi fondin rezerve , emergjencen dhe kontigjencen, transferimin e kuotes se Kshillit te Qarkut , dhe transferta te tjera si Ndermarrjes UK, dhe Drejtorise Rajonale te Tatimeve.
- ❖ Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi,
- ❖ Sherbime publike vendore , pastrim qyteti she zona rurale, mirembajtje varrezash publike dhe te deshmoreve.
- ❖ Transfeta e fondeve Futboll Klub “Tomori 1923.
- ❖ Investimet publike sipas programeve perkatese, (Aneksi 5).

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Emertimi shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 8Mujori Janar-Gusht 2018	Realizimi buxhetit 8 MujoriJanar-Gusht 2018	% e realizimit
600+601	129,161	93,457	80,792	87
602-609	48,444	32,389	21,991	68
F.rez.emergj.	16,801	13,161	846	7
Sh.publike	65,759	44,134	40,655	92
Transf.futb.	27,530	20,030	18,946	95
Shpenz.korent.	387,695	196,829	163,230	83
230-231	317,677	238,792	120,102	50
Totali	605,372	441,963	283,332	64

Realizimi i shpenzimeve të 8- mujori , paraqitet ne masen 64% për këtë Njesi Shpenzuese. Bashkia Berat (aparati administativ) menaxhon rreth 54.5 **përqind** të totalit të buxhetit te Bashkise Berat dhe sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor 287 695 000 leke,
 plani 8- mujor, 196 829 000 leke
 fakti 8- mujori 163 230 000 leke
realizimi 83%.

Totali i shpenzimeve kapitale realizimi ne masen 50 %, informacion i detajuar jepet aneksin nr.5, te kolona komente.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Artikulli 600+601, shpenzime personeli është realizuar në masën 87%, mosrealizimi në masën 7 805 000 leke, ose 13 %, si rezultat i vendeve vakante dhe procedurave të rekrutimit të punonjësve që kanë afatet e caktuara, dhe mos përdorim të fondit vecantë.

Jane derdhur rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit pranë organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë realizuar në masën 68%.

Jane likuajduar detyrimet e trashëguara nga viti 2017, janë shlyer rregullisht detyrimet ndaj të tretëve si ndaj OSHEE, Ujesjelles kanalizimeve, shpenzimet telefonike dhe interneti. Janë kryer rregullisht pagesat e keshilltareve dhe kryetareve të fshatrave sipas listeprezençave të paraqitura. Mosrealizimi ka të bëjë me planifikimin e prokurimeve për blerje dokumentacioni dhe shtypshkrime, blerje shërbimi të printimit, procedura të cilat në lidhje kontarte, ose në rastin e karburantit, pavarësisht planifikimit në katërmujorin e parë, procedura u shty deri në maj.

Shpenzimet korrente u kryen për të realizuar aktivitetet:

- Realizimi i pagesës së pagave dhe të sigurimeve shoqërore për nënpunësit dhe punonjësit e bashkisë.
- Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë nëpërmjet procedurës së prokurimit për blerje dokumentacioni, shërbim printimi,
- Sigurimi i materialeve dhe shërbimeve speciale.
- Realizimi i shërbimeve ndaj të tretëve.
- Realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Sigurimi i levizjes së nënpunësve dhe realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Mirëmbajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe vetë ambienteve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme.
- Realizimi i shpenzimeve për pritje përcjellje.
- Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

Realizimi analitik i shpenzimeve paraqitet me poshtë:

	Emertimi i shpenzimit	Plani /lek	Fakti/lek
6020	Blerje kancelarie	600,000	569,300
6020	Blerje materiale pastrimi	150,000	67,020
6020	Blerje dokumentacioni	300,000	200,440
6020	Shërbimi i printimit	600,000	-
6020	Furnizime materiale të tjera	500,000	66,000
6021	Blerje uniforma	270,000	226,800
6022	Energji	2,200,000	1,707,082
6022	Uje	1,000,000	883,137
6022	telefon	80,000	33,466
6022	Shpenzime postare	1,000,000	762,487

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

6022	te tjera shpenzime	1,200,000	1,043,059
6023	karburant	1,800,000	1,365,454
6023	pjese kembimi	1,100,000	1,060,100
6023	siguracione	75,000	52,467
6023	shpenzime te tjera	75,000	15,175
6024	Shpenzime udhetim dieta	1,250,000	1,222,756
6025	Shpenzime mirembajtje	500,000	384,000
6028	Shoqata e bashkive	300,000	300,000
6029	shpenzime pritje percjellje	600,000	71,640
6029	Aktivitete	800,000	530,726
6029	Shpenzime gjyqesore	7,316,000	3,029,296
6029	K.artistik,KPP	130,000	130,000
6029	K.Bashkiak,K.fshatrave	5,555,000	5,534,810
6029	te tjera shpenzime	500,000	184,765
	Shuma	27,901,000	19,439,980

Sherbimet publike (pastrim qyteti dhe zonat rurale, si dhe mirembajtja e varrezave publike dhe te deshmoreve) qe i perkasin programit **Sherbime publike vendore**, sipas paqyres se mesiperme realizimi eshte 92% , ne fakt, subjektet e kontraktuar per kryerjen e sherbimeve jane likujtuar plotesisht kundrejt fatures se TVSH dhe situacionit te situacionit te sherbimit te kryer.

Transferimi i fondeve kundrejt Futboll Klub “Tomori 1923”, jane planifikuar per 8-mujorin 20 030 000 leke, dhe ju eshte alokuar 18946 000 leke, ose 95% e buxhetit te planifikuar. Eshte transferuar fondi kundrejt kerkeses se paraqitur per shpenzimet realisht te domozdoshme, duke mos krijuar borxhe te reja.

Artillulli 230-231 realizimi paraqitet ne masen 50%, informacioni i detajuar jepet aneksin nr.5, te kolona komente.

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPETIMI

Realizimi i shpenzimeve sipa ndarjes ekonomike paraqitet si me poshte:

000/ leke

Emertimi shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti Mujori 2018	Realizimi buxhetit 8 Mujori 2018	% e realizimit
600+601	32,991	23,661	17,598	75
602-609	4,963	4,150	2,396	58
Totali	37,954	27,811	19,994	72

MZSH			
	Enertimi i shpenzimit	Plani/lek	Fakti/lek
6020	Blerje dokumentacioni	15,000	
6021	Blerje uniforma	20,000	
6022	Energji	670,000	359,769
6022	Uje	400,000	205,907
6022	te tjera shpenzime	31,000	22,440
6023	karburant	1,500,000	927,603



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

6023	pjese kembimi	1,400,000	879,786
6023	siguracione	114,000	-
	Shuma	4,150,000	2,395,505

NJESIA SHPENZUESE NDERMARRJA E GJELBERIMIT

Menaxhon 36 % te buxhetit total . Fondet jane planifikar, celur dhe realizuar ne nje program: Sherbime publike vendore. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor te rishikuar, rezulton si me poshte:

Shpenzimet korente, plani vjetor	41.236.000 leke,
Plani 8 mujorit te pare,	29.660.000 leke
Fakti 8 mujorit te pare	26.989.000 leke

Realizimi 91 %.

Politika e këtij programi eshte permirësimi i kushteve mjedisore sa me te kendshem dhe funksionale, brenda standardeve bashkekohore, krijimit te nje ambienti shlodhes dhe qetesie ku qytetaret te kalojne nje pjese te kohes se tyre, duke nderhyre edhe ne blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti.

Objektivat e Programit per kete tetemujor :

- Mirembajtjen e struktures se siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure te gjelber.
- Shtimi i siperfaqeve te gjelberta duke shtuar mbjelljet me lule sezonale, siperfaqe me bar, mbjellja e pemeve dekorative etj.
- Mirembajtja e tendave dhe e pjergullave.
- Mirembajtja e qoshkave dekorative, tavolinave dhe stolave ne te gjitha siperfaqet e gjelberta.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar produktet:

- Kryerjen e te gjitha proceseve teknologjike te punes si punim toke, vaditje, prashitje, krahsitje, plehrim, pastrim, grumbullim mbeturinash etj. ne nje siperfaqe te gjelber prej 93.203 m2 ku nga kjo 16.804 m2 eshte siperfaqe rruge e sheshe. 70.336 m2 eshte siperfaqe bar (tapete), 4.821 m2 siperfaqe lule.
- Mirembajtja e 467 stolave per te ofruar gjithmone vende shplodhjeje per qytetaret.
- Mirembajtje e gjithe inventarit te perfshire ne siperfaqet e gjelberta si, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicuesa, cezma zbukuruese, kende lojrash per femije, e kende argetuese per moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.

Mjellja me lule sipas sezoneve e 4821 m2 siperfaqe lulesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Aktivitetet qe u realizuan

- Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per nenpunesit dhe punonjesit e Ndermarrjes se Gjelberimit, realizimi i planit 94 .8%. mosrealizim mbetet fondi I vecante ne masen 5%
- Realizimi i shpenzimeve operative ne masen 76 % te planit te 8 mujorit, u shlyen detyrimet e mbartura nga viti 2017 ne masen 1.042 mije leke
- Jane shlyer rregullisht detyrimet ndaj OSHE, Ujsjells kanalizimeve , shpenzimet telefonike dhe internet si dhe shpenzimet e transportit. Mbetet pa realizuar nje fond prej 24 % pasi jane ne process tenderimi dhe proces shlyerje.
- Realizi i nvestimeve paraqitet ne pasen 86 %, 14 % mos realizim i perket aresyes te paraqitjes se ofertave me te uleta.

Sipas ndarjes ekonomike paraqiten keta tregues te permbledhurte realizimit te buxhetit 000 leke

Emertimi i shpenzimeve	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan buxheti 8 mujor 2018	Realizimi I 8 mujorit 2018	% e realizimit
600+601	32997	23583	22365	94.8
602-609	7939	5777	4365	95.5
230-231	300	300	259	86
Totali	41236	29660	26989	91

NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE.

Njesi shpenzuese menaxhon 7.53% te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

1. Programi 4530: Mirembajtje rruges, trotuaresh sheshesh , kalldremesh, ndicim publik , sinjalistike rrugore, rrjetesh te kullimit te ujrave te bardha.
2. Programi 4520: Mirembajtje rruges rurale.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:
Shpenzimet korente,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Plani Vjetor	45 922 000 leke
Plani i 8-mujorit te pare	31 642 000 leke
Fakti I 8-mujorit te pare	27 807 000 leke
Realizimi ne %	88%

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit të ndicimit publik. Mirembajtja e rrugeve rurale.

Objektivat e Programit

- Permiresimin e rrjetit ekzistues te rrugeve te asfaltuara, urbane dhe rurale që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve.
- Mirembajtjen e trotuare, kalldre ekzistuese si dhe shtimin e sipëfaqe te reja.
- Mirembajtjen e rrjetit ekzistues te ndricimit public dhe mundesimin e e krrimit te zonave te reja te ndricuara ne periferi te qytetit.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar produktet:

1.Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.

Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës.

Gjatesia totale e rrugeve ne te gjithë teritorin e Bashkise Berat eshte 812 km, nder te cilat 624 km jane rruget rurale dhe 188 km jane rruget urbane.

Siperfaqja totale e rrugeve eshte 857 323 m2 ne te gjithë teritorin e Bashkise nga te cilat 239 231 m2 jane te trajtuara me asfalt dhe 618 092 m2 me stabilizant.

Mirembajtje e urave 13 cope.

2.Mirëmbajtja e Rrugëve me kalldrem dhe trotuareve.

Mirëmbajtja e rrugeve ekzistuese me kalldrem dhe shtimi i sipërfaqeve te reja . Gjithsej kemi 80 942 m2 qe do te mirmbahen.

3.Mirëmbajtja e shesheve;

4.Mirëmbajtja e sistemit te kanalizimeve te ujrave te bardha , te larta dhe i pusetave ne Njesine Administrative nr. 1 , nr. 2 , nr. 3 , Velabisht , Sinje , Otlak , Roshnik.

- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve te ujrave te bardha ne 830 zgara te vogla ekzistuese ne Njesite Admin. Nr. 1 , nr. 2 , nr. 3.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi kanalizimeve te ujrave te larta ne 30 zgara pritese te medha ne te gjithë teritorin e bashkise Parashikohet te vendosen zgara pritese per ujrata e larta 50 cope ne te gjithë teritorin e Bashkise.
- Pastrimi i perrenjve te meposhtem :
- Perroi i Kananit, Perroi i Lisit i Te Becit, Perroi i Suelasit , Perroi Pusi me Cati , Perroi i MCR, Perroi ne lagjen Nr.1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave, duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.

Mirëmbajtje Ndriçimi Rrugor.

Përfshihet mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët e qytetit dhe fshatrat, riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, që kap nje gjatesi te ndicuar prej 37.89 km.

Mirëmbajtja e rrugëve rurale te asfaltuara (Inventari i rrugëve sipas VKM nr 915 dt 11.11.2015)

Rruga Sinje – Velçan 8 km, Rruga K/ Dyshniku – Roshnik 1.1 km, Rruga Duhanas – Roshnik 8 km, Rruga K/Velabishtit – Starove 1.5 km, Rruga K/ Gjerovenit – Gjeroven 4 km, Rruga K/ Duhanasit – Duhanas 4 km, Rruga K/ Bilç – Malinat 18 km, Rruga Ure Vajguore – Veterik 3 km, Rruga K/ Lapardhase – Lumas 12 km, Rruga Berat – Sinje 22 km.

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:
000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 8-mujori Janar-Gusht 2018	Realizimi buxhetit Janar-Gusht 2018	% e realizimit
600+601	37984	27054	25035	92%
602-609	45922	31642	27807	88%
230-231	2 214	2 014	300	15%
Totali	86120	60710	53142	87%

Ndermarrja e Sherbimeve Publike, program 4530

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 8-mujori Janar-Gusht 2018	Realizimi buxhetit Janar-Gusht 2018	% e realizimit
600+601	35 545	25 339	24 577	97%
602-609	43 585	29 819	25 984	87%
230-231	2 214	2 014	300	15%
Totali	81 344	57 172	50 861	89%

Rruget Rurale, program 4520

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 8-mujori Janar-Gusht 2018	Realizimi buxhetit Janar-Gusht 2018	% e realizimit
-----------------------	---------------------	--	-------------------------------------	----------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

600+601	2439	1715	458	27%
602-609	2337	1823	1823	100%
230-231	0	0	0	0
Totali	4776	3538	2281	64%

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 92%, mosrealizimi me masen 2 019 000 leke, ose 8%, , dhe mos perdorim te fondit vecante. Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes jane realizuar ne masen 88%

(602) Shpenzimet operative

(6020) Materiale zyre dhe te pergjithshme.

Nuk eshte realizuar zeri kancelari per arsye se eshte shtyre procedura per ne muajin shtator 2018 ne vleren 120000 leke

(6022) Sherbime nga te tretet.

Jane likujduar faturat e OSHE si dhe detyrimi I trasheguar nga viti 2017 ne vleren 2104404 leke.

Jane shlyer rregullisht faturat per vitin 2018 ne vleren 15702713 leke .

Jane shlyer faturat e ujit ne menyre te rregullt per vitin ne vazhdim.

Jane shlyer faturat per sherbim internet 2018.

(6023) Shpenzime transporti.

Ne zerin karburant kemi shlyer deyrimet nga viti 2017 ne vleren 1385382 leke si dhe jane shlyer faturat deri ne muajin korrik 2018.ne vleren 1966039 leke. Kontrata e lidhur per vitin 2018 ka vleren 5249765 leke.

Kemi shlyer nga viti I kaluar 2017detyrimin Pjes makine sherbime mjete ne vleren 2488469 leke.Per vitin 2018 kemi lidhur kontraten me vleren 2808000 leke.

Kemi bere siguracionin e mjeteve te transportit ne vleren 143000 leke.

Eshte prokuruar dhe shlyer kontrata vajra makine ne vkleren 298200 leke

(6025) Shpenzime mirmbajtje.

Ne zerin mirmbajtje jane likujdar detyrimet e vitit te kaluar 2017 ne materiale elektrike per mirmbajtje rrjeti elektrik ne vleren 1576014 leke. Eshte lidhur kontrata e vitit 2018 ne



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

vleren 2700000 leke. Ka perfunduar kontrata conform ligjit dhe kushteve te kontrates me daten 17/08/2018.

Eshte lidhur kontrata per materiale ndertimi per vitin 2018 ne vleren prej 3511680leke dhe eshte realizuar dhe likuduar ne vleren 3136080leke.

(6029)) **Shpenzime te tjera operative**

Jane shlyer detyrimet per shpenzime gjyqesore ne vleren 531500 lek . Per vitin 2018 kemi mbartur nje detyrim prej 7 779 727 leke . Kjo per arsye te fondit limit te vendosur ne thesar ne fond te vitit 2017. Ky detyrim eshte shlyer ne kater mujorin e pare te vitit 2018, duke i dhene prioritet faturave te prapambetura.

Nga 8 mujori 2018 ka lindur detyrime si me poshte:

Materiale elektrike me vlere te fatures 2 697 840 leke

Pjese kembimi te mjeteve ne vleren 995 000 leke

Karburanti me vlere te fatures 907260 leke.

Kemi detyrim te prapambetur me OSHE prej vitit 2007 -2017 ne vleren prej 9 282 322 leke .

Ky detyrim I OSHE . do te paguhet me keste sipas nje marreveshje te lidhur midis institucioneve perkarese.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar aktivitetet:

- Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per punonjesit e Ndermarrjes se Sherbimeve Publike.
- Plotesimi i kerkesave per kushte normale te punes ne administrate nepermjet procedures se prokurimit per blerje dokumentacioni, sherbim printimi,
- Sigurimi i materialeve dhe sherbimeve speciale.
- Realizimi i sherbimeve ndaj te treteve.
- Realizimi i shpenzimeve te transportit..
- Mirembajtja e mjeteve te transportit, pajisjeve te zyrave dhe vet ambienteve te zyrave nepermjet realizimit te shpenzimeve te, mirembajtjes se zakonshme.
- Realizimi i shpenzimeve te tjera operative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Artikulli 230-231 realizimi paraqitet ne masen 15%, mosrealizimi 85% per arsye te spostimit ne regjistrin e prokurimeve ne muajin Shtator artikullin “Ndertim muri”.

DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE , UJRAVE DHE SHERBIMIT VETERINAR,

Menaxhon 4.25 % te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

- ❖ *Programi i Mirëmbajtjes së kanaleve ujitse dhe kulluese*
- ❖ *Planifikimit te mbrojtjes dhe shtimin e sipërfaqes pyjore*
- ❖ *Programi i sektorit te bujqesise*

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbledhur te realizimit te buxhetit:

000/leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan Buxhet 8/mujor 2018	Rrealizimi 8 mujor Janar-Gusht 2018	% e realizimit
600+601	22807	16050	13701	85
602-609	23496	19769	13754	70
230-231	2298	2298	2297	99
Totali	48601	38117	29752	78

1* *Administrimi,shfrytezimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit*

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor	25 483 000 leke,
planin 8- mujori	21 256 000 leke
fakti 8- mujori	15 504 000 leke
realizimi 73%.	

Politika e Programit, konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkise Berat, me qëllim që t’iu mundësojë fermerve ujitjen dhe kullim normal në cdo parcele toke , krijimin e kushteve infrastrukture dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te kanaleve ujitse dhe kulluse. Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 27, Funkcionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika1:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

VKM Nr.1108, datë 30.12.2015, “Transferimi, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, ka kaluar në administrim të Bashkisë, që ndjek politikën vendore, harton programin e ndërhyrjes, termat e referencës dhe standartet, funksionon edhe Drejtoria e Administrimit të pyjeve dhe Ujërave dhe Sherbimit Veterinar me sektorin e Ujitjes dhe Kullimit e përbërë nga 5 punonjës, teknikë dhe punëtorë të cilët kanë detyrë të kryejnë dhe të ndjekin në territor zbatimin e punimeve që kryhen për pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese.

Ndërhyrja për pastrimin e kanaleve kulluese siguron mbajtjen në nivelet optimale të ujërave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete.

Ndërhyrja në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse, dhe veprave të artit që sigurojnë mirëfunksionimin e tyre, është e domosdoshme për të bërë të mundur realizimin e rendimenteve të parashikuara nga fermerët për kulturat e ndryshme bujqësore.

Ndërhyrja në mirëmbajtjen e argjinaturave, përveç mbajtjes nën kontroll të tyre, parashikon dhe mirëmbajtje të pjësëshme sipas rregullores së mirëmbajtjes së veprave të mbrojtjes nga lumenjtë. Persa i perket kanaleve vaditëse për të gjitha njesitë administrative të bashkisë së Beratit janë ngritur **5 shoqata** sipas ligjit në fuqi për mirëmbajtjen e kanaleve dhe shpërndarjen e ujit për vaditje të fermerëve.

Aktivitetet kryesore të projektit

1. Evidentimi në vazhdimësi i problematikave kryesore të sistemit ujitës dhe kullues
2. Hartimi i planeve të ndërhyrjeve për pastrim dhe rehabilitim Kanaleve Ujitëse dhe Kanaleve Kulluese.
3. Përcaktimi i volumeve të punës në objektet ku do të ndërhyhet
4. Kryerje e punimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese në të gjithë territorin e bashkisë Berat dhe njesitë Administrative gjithsej 11 km kanale .

Shpenzime për mirëmbajtje kanale Kulluese	Vlera	6889580
Shpenzime të tjera Saracineska	Vlera	512844
Shpenzime Qiramarrje Mjete transporti	Vlera	610000
Shpenzime Objekte Nderimore	Vlera	520000
Shpenzime siguracione mjetesh	Vlera	229800
Blerje Vaj	Vlera	454800
Supervizim për mirëmbajtje kanale Kulluese	Vlera	123778

Jane prokuruar nga Bashkia 2 tendera

Mirëmbajtjen e mjeteve të transportit për drejtorinë me vlerë 2.760.000 leke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Dhe blerje karburanti ne vleren 3.000.000 leke

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbledhur te realizimit te buxhetit:

00/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan Buxhet 8/mujor 2018	Rrealizimi 8 mujor Janar-Gusht 2018	% e realizimit
600+601	4257	3258	2721	84
602-609	21225	17998	12783	71
230-231	0	0	0	0
Totali	25482	21256	15504	73

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 84%, mosrealizimi me masen 918.000 leke, u trasheguan nga viti 2017 leke 880.000 ,numri i punonjesve si ne vitin 2017 dhe ne vitin 2018 ka qene 5 punonjes. Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes jane realizuar ne masen 71%. Jane likujduar detyrimet e trasheguara nga viti 2017

Jane shlyer rregullisht detyrimet ndaj te treteve si ndaj OSHEE, Ujesjelles kanalizimeve, shpenzimet telefonike dhe interneti.

Mosrealizimi ka te bej me planifikimin e prokurimeve per blerje karburant , sherbime per mjetet e transporti , rehabilitimi i kanaleve Kulluese jane me kontrata deri ne fund te vitit 2018 dhe likujdimi do behet sipas afateve te kontratave.

2-Programi i planifikimit te mbrojtjes dhe shtimin e siperfaqes pyjore

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor	4. 818 000 leke,
plani 8- mujori	3.460.000 leke
fakti 8- mujori	2.669. 000 leke
realizimi	77%.

Përshkrimi i programit:

Kosiston ne marrjen e masave per eliminimin e erozionit, krijimin e nje mjedisi sa me te paster, uljen e ndotjeve te ajrit etj. Pyllzime te reja,sistemime malore,trajtime silvikulturore ne Njesite Administrative Velabisht,Otllak,Roshnik,Sinje.

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbledhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

<i>Emertimi i shpenzimit</i>	<i>Plan Buxhet vjetor 2018</i>	<i>Plan Buxhet 8/mujor 2018</i>	<i>Rrealizimi 8 mujor 2018</i>	<i>% e realizimit</i>
600+601	3269	2699	2104	79
602-609	991	761	565	74
230-231	0	0	0	0
Totali	4818	3460	2669	77

Artikulli 600+601, shpenzime personeli është realizuar në masën 79%, mosrealizimi në masën 596.000 leke, pasi në këtë artikull u trashëguan nga vite 2017 leke 130.000 që përben 23% të diferencës, numri i punonjësve si në vitin 2017 dhe në vitin 2018 ka qenë 5 punonjës. Janë derdhur rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit pranë organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë realizuar në masën 74%. Mosrealizimi ka të bëjë me planifikimin e prokurimeve për blerje karburant, me kontrata deri në fund të vitit 2018 dhe likuidimi do bëhet sipas afatëve të kontratave.

Blerje fidane dhe produkte		99000
Agrikulture	Vlera	
Veshje dhe uniforma	Vlera	367200
Materiale dhe Shërbime Speciale	Vlera	118000

Struktura e Pyjeve në drejtori ka 5 punonjës midis tyre 2 inxhinier pyjesh dhe të cilët mbulojnë të gjithë territorin e bashkisë Berat me një sipërfaqe 16.201 ha pyjesh. Inspektimet në të gjithë zonën janë kryer për 8 mujin nga të cilat ka pas dhe konfiskime të lendeve drusore të ndryshme të cilat janë depozituar pranë kësaj drejtorie në 93.2 mst (Lis dhe mare). Me vlerë 164.000 leke dru mare dhe 82.800 lek dru lis.

Struktura e pyjeve dhe mbrojtës nga zjarri për 8 mujin 2018 ka bërë kontroll të perseriturës në parandalimin e zjarre në kullota e pyjeve dhe për rastet kur ka pas sinjalizime për zjarre ka qenë gjithë kohën në gadishmeri dhe ka pas rezultate shumë të mira në fikjen dhe mosperhapjen e zonalit. gjatë vitit 2018 punonjësit e kësaj strukture janë pajisur me të gjitha mjetet dhe veshjet për përballimin e situatave të krijuara.

3. PROGRAMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË

Ky sektor është i fokusuar në zbatimin e VKM 994 DT 09.12.2015 “Për procedurat e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi.” Ky realizim vjen si rezultat i bashkëpunimit me ZVRPP dhe prefekturën.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

<i>Shpenzimet korentë, plani vjetor</i>	<i>18 300 000 leke,</i>
<i>planit 8- mujorit të parë,</i>	<i>13 401 000 leke</i>
<i>fakti 8- mujorit të parë</i>	<i>11 474 000 leke</i>
<i>realizimi</i>	<i>86%.</i>

Sektori i Bujqësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Për perjudhën Janar – Gusht 2018 si sektor me anë të specialisteve te kadastrës pranë kësaj drejtorie, eshte punuar maksimalisht për tju dhënë zgjidhje sipas procedurave ligjore, të gjitha problemeve që na janë paraqitur pranë drejtorisë tonë apo në Nj. Administrative, si nga fermerët ashtu dhe nga institucionet e tjera si ZVRPP Berat, Prefektura Berat, Ministria e Bujqësisë, Qarku Berat, Projekti TAP etj.

Fondi i tokë bujqësore gjithsej si Bashki = 14764 Ha nga kjo:

Tokë shtetërore = 3324 Ha

Tokë e kultivuar = 11440 Ha (mar me ligjin 7501) nga kjo mbjellë me kulturat si më poshtë:

- Ullishte 3724 ha
- Pemë frutore 1143 ha
- Vresht 653 ha
- Bimë arash 5920 ha (drithra, perime, foragjere etj.)

Si Bashki Akte Marrje Toke në Pronësi gjithsej 9990 Akte. Në Zonat Kadastrale të Bashkisë Berat ka përfunduar regjistrimi fillestar i tokave bujqësore, përveç zonës së Uznovës të cilën e kemi duke e trajtuar, theksojmë se kjo është një zonë në zhvillim me shumë ndërtime të reja dhe informale.

Puna jonë në zbatim të VKM Nr.994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” paraqitet sipas tabelës :

Nr	EMERTIMI	Kërkesa gjithsej	Konfirmime	Në Proçes
1	Nj.Ad.Otllak	81	64, rikon17	11
2	Nj.Ad.Velabisht	74	61, rikon15	13
3	Nj.Ad.Sinjë	24	18, rikon 3	6
4	Nj.Ad Roshnik	21	14, rikko 2	5
5	Ullishtja Berat	10	-	10
6	Uznova	-	Duke u trajtuar	1230
	Bashkia Berat	210	157, rikon 37	45 + 1230 Uznova

Nga ana jonë janë trajtuar të gjitha kërkesat e paraqitura dhe sipas rastit kemi dërguar kërkesë për plotësim dokumentacioni ZVRPP Berat, fermerëve apo institucioneve te tjera.

- Ne 2017 për Rajonin Uznovë janë paraqitur gjithsej **1250** (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) Akte të cilat janë trajtuar nga ana jonë dhe i kemi bërë kërkesë:
 - Këshillit të Qarkut Berat me shkresën me nr.236/8 datë 25.04.2017 kërkesë dokumentacioni dhe Qarku na kthen përgjigje që nuk disponon normën për frymë dhe për zërin kadastral duhet të interesohen vetë fermerët.
 - Zyrës së Gjendjes Civile Uznovë që të na dërgojnë çertifikatat familjare te datës 01.10.1992 te perfituesëve, deri tani nga ana e Zyrës të Gjendjes Civile Uznove na



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

janë vënë në dispozicion **168** Çertifikata të përbërjes familjare të datës 01.10.1992 të cilat janë trajtuar nga ana jonë.

- Sigurimeve Shoqërore nëse kanë qënë punonjës të ish - NB Uznove deri në dt.01.10.1992, deri tani nuk kemi marë përgjigje.

Kontrolli dhe siguria ushqimore per konsumatorët

D.A.P.U&ShV ka ne organiken e saj dhe 3 Veteriner te cilet mbulojne te gjithe territorin e bashkise Berat per te bere kontrolle te vazhdueshme per mbrojtjen e konsumatorit.

Gjate 8 mujorit ata kane arritur te japin certifikata veterinare gjithsej 2136 cope per kafshe te tipit gjedh dhe te imta te cilat kane kaluar si te ardhura ne buxhetine bashkise Berat ne vleren **720.950 leke** .

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan Buxhet 8/mujor 2018	Rrealizimi 8 mujor 2018	% e realizimit
600+601	14722	10093	8876	88
602-609	1280	1010	406	40
230-231	2298	2298	2297	99
Totali	18300	13401	11474	86

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 88%, .Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

